



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN 2020

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkjmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: z.Smajl Latifi, Kryetar

Adresa: Rruga Dëshmorët e Pashtrikut pa nr. Rahovec, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Rahovecit (KR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Rahovecit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Rahovecit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B1 Në 1,321 raste pagesat në vlerë totale 2,661,959€ ishin realizuar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh.
- B2 Pagesa pa raporte detaje të pranimit për kryerjen e shërbimeve/angazhimeve në vlerë 86,431€.
- B3 Në katër raste ishin nënshkruar kontrata për projekte kapitale në vlerë 650,887€ deri sa nuk kanë pasur mbulueshmëri financiare.
- B4 Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në prone.
- A1 Në shtatë raste komuna nuk kishte realizuar punimet sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë, pra kishte vonesa domethënëse në progresin fizik në këto projekte.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Komuna për shkak të planifikimit jo të duhur kishte realizuar një pagesë në vlerë 7,170€ "Furnizim me inventar për objektin e emergjencës" nga kategoria e investimeve kapitale përderisa këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinioni i auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Rahovecit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Rahovecit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Rahovecit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Rahovecit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Rahovecit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja

Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore duhet të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimin të faturës.

Nga analiza e bazës së furnitorëve kemi identifikuar se në 1,321 raste pagesat në vlerë totale 2,661,959€ ishin realizuar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh. Vonesat variojnë nga një muaj deri në 5 vite.

Shkaku i kësaj dukurie ishte hyrja në obligime pa fonde të mjaftueshme, si dhe mos funksionimi i kontrollit të brendshëm.

Ndikimi

Hyrja në obligime pa mbulesë të mjeteve dhe vonesat në pagesa mund të ndikojë në rritjen e obligimeve të cilat krijojnë implikime buxhetore për vitin vijues dhe rrezikojnë të shkaktohen shpenzimeve shtesë për shkak se pagesat mund të realizohen direkt nga Thesari bazuar në vendime gjyqësore/përmbartimore.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme dhe që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Pagesa pa raporte detaje të pranimit për kryerjen e shërbimeve/angazhimeve**Gjetja**

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik (Rr.UOPP) neni 10 pika 1e parasheh që njësia kërkuuese nxjerr raporte për pranimin e mallrave/shërbimeve/punëve për aranzhimin e pagesës për operatorët si dhe Rregulla financiare Nr. 01/2013/MF – Shpenzimi i parave publike neni 23 paragrafi 1 Pranimi i mallit/ shërbimit bëhet nga zyrtari/komisioni i autorizuar.

Në gjashtë ⁵ raste pagesat në vlerë 86,431€ për muajt përkatëse, për projektin ‘Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit Shtretërit shtëpiak’, ishin realizuar pavarësisht faktit që komisioni për pranimin e shërbimeve nuk kishte përgatitur raporte detaje për shërbimet/angazhimet e realizuara.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit të mirë të kontrollit të brendshëm.

Ndikimi

Realizimi i pagesave në mungesë të dëshmive se shërbimet janë realizuar sipas kontratës rrit rrezikun e pagesave për punë/shërbime të pa kryera dhe njëherësh ndikon në dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të iniciojë një rishikim të zbatimit të kësaj kontrate për të siguruar se ajo po zbatohet sipas specifikimeve të kontraktuara. Për secilin muaj duhet të hartohen raporte detale për secilin shërbim të ofruar dhe pagesat duhet të bëhen vetëm pasi të jetë marrë siguria se shërbimet janë pranuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Nënshkrimi i kontratave pa mbulueshmëri financiare****Gjetja**

Bazuar në Ligjin Nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, neni 12 limitet në zotime dhe shpenzime, pika 8 Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2020 dhe për dy (2) vitet në vijim.

Në katër raste ishin nënshkruar kontrata për projekte kapitale deri sa nuk kanë pasur mbulueshmëri financiare si :

1. Për projektin “Rregullimi i shtratit të Lumit në Remnik” me ligjin e buxhetit për vitin 2020 dhe dy vitet pasuese janë paraparë 85,000€, ndërsa kontrata e nënshkruar me dt. 03.11.2020 ishte në vlerë 508,862€ apo 423,862€ më e lartë se vlera e planifikuar;
2. Për projektin “Ndërtimi i semaforëve të rinjë” me ligjin e buxhetit për vitin 2020 dhe dy vitet pasuese janë paraparë 40,000€, ndërsa kontrata e nënshkruar me dt. 18.09.2020 ishte në vlerë 49,982€, apo 9,982€ më e lartë se vlera e planifikuar.

3. Për projektin "Ndërtimi i QMF në Opterushë" me ligjin e buxhetit për vitin 2020 dhe dy vitet pasuese janë paraparë 55,000€, ndërsa kontrata e nënshkruar me dt.22.06.2020 ishte në vlerë 81,543€, apo 26,543€ më e lartë se vlera e planifikuar si dhe ;
4. Për projektin "Ndërtimi i kioskut" me ligjin e buxhetit për vitin 2020 dhe dy vitet pasuese janë paraparë 5,000€, ndërsa kontrata e nënshkruar me dt.22.10.2020 ishte në vlerë prej 10,500€, apo 5,500€ më e lartë se vlera e planifikuar.

Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të mangëta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre.

Ndikimi

Mungesa e analizës së mirëfilltë të kostove financiare për projektet kapitale, dhe nënshkrim i kontratave për tej limiteve buxhetore, krijon vështirësi dhe çrregullon rrjedhën financiare të komunës duke qenë se duhet të bëhen shumë përshtatje buxhetore dhe ri destinime të mjeteve për të mbuluar deficitin e këtyre projekteve. Kjo pamundëson realizimin e projekteve tjera të parapara të realizohen nga mjetet e ri destinuara.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të siguroj se do të aplikoj ligjin e prokurimit - të inicioj një aktivitet prokurimi vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave dhe të nënshkruaj një kontratë për projekte kapitale vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë.

Gjetja

Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11 pika 1 definon: "Zbritja për vendbanimin parësor- Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000€) nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Po ashtu, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë ka njoftuar komunat për vendimin e marr me dt. 16,04,2021 për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, kjo me qëllim të shmangies së duplikimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni. Për më tepër, regjistrimi i numrave personal rrit efikasitetin, garanton informata më të sakta dhe të besueshme në regjistrin e tatimit në pronë dhe sjell përfitime të tjera të shumta për tatimpaguesit.

Lidhur me këtë kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- Katër nga tetë mostrat e testuar, tatimpaguesit që nuk posedonin prona të regjistruara për vendbanim parësor, komuna ju kishte lejuar zbritjen prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e pronës. Po ashtu, nga analiza e data bazës për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se zbritja ishte aplikuar tek 294 prona të cilat

nuk ishin të regjistruara si vendbanim parësor. Si rezultat i kësaj komuna ka ngarkesa tatimore vjetore më të ulëta në vlerë të përafërt prej 7,056€. Neglizhenca e zyrtareve kompetent ka ndikuar që gabimet të mos përcjellën tek zyrtarët e nivelit qendror për korigjimet e nevojshme, si dhe;

- Katër nga tetë mostrat e testuar ishte aplikuar zbritja për pronat personave që nuk kishin të evidentuar numrin personal. Po ashtu, nga analiza e data bazës për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se 756 personave iu ishte bërë zbritja pa numër personal ku për pasojë rezultoi afër 18,144€ më pak të hyra nga kjo kategori.

Zyrtarët komunal theksuan se kanë marrë përgjigje nga departamenti i tatimit në pronë në MF se “Ky problem do të vazhdojë të ekzistojë deri sa të plotësohet numri personal për të gjithë tatimpaguesit” dhe tek në vitin 2021 zbritja nuk do të aplikohet për këto raste.

Ndikimi

Vlerësimi i njësive rezidenciale me zbritje pa numër personal, dhe pa deklarim se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me kalkulim të parregullt të zbritjes apo shmangie nga tatimi në pronë, ku për pasojë komuna pranon më pak të hyra nga kjo kategori.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të siguroj bashkëpunim më të mirë në mes të tatimpaguesve, departamentit të Tatimit në Pronë-Komunës dhe departamentit të Tatimit në Pronë-Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventual.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Menaxhim i dobët i kontratave/Vonesa në realizimin e projekteve

Gjetja

Sipas nenit 81 të Ligjit për Prokurim Publik si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik pika 61.6, 61.19 dhe 61.20, menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Në shtatë (7) raste komuna nuk kishte realizuar punimet sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë, pra kishte vonesa domethënëse në progresin fizik në këto projekte:

- Projekti “Ndërtimi i kompleksit përkujtimor”, vlera e kontratës 475,239€ e dt.25.09.2012 duhej të përfundonte brenda tri viteve (në vitin 2014). Megjithatë projekti është përfunduar me datë 14.09.2020, pra me gjashtë (6) vite vonesë;
- Projekti “Kanali i kullimit të tokave bujqësore ‘vlera e kontratës 497,981€ e dt. 01.10.2013 duhej të përfundonte brenda dy (2) viteve (në vitin 2015), ende nuk ka përfunduar;
- Projekti “ Ndërtimi i rrugës Rahovec-Potiçan i poshtëm” vlera e kontratës 845,981€ e dt. 16.09.2016 duhej të përfundonte për 158

ditë pune, ende nuk ka përfunduar;

- Projekti " Ndërtimi i rrugëve ne Xerxe, Celine, Nashpall, Senoc, Retije dhe Mrasor' vlera e kontratës 359,702€ e dt. 14.10.2016 duhej të përfundonte për 140 ditë pune, ende nuk ka përfunduar;
- Projekti " Ndërtimi infrastrukturës Vrajak, Gexhe, Zatriq, Sopniq dhe Retij e ulet" vlera e kontratës 283,994€ e dt. 29.08.2015 duhej të përfundonte në vitin 2016, ende nuk ka përfunduar;
- Projekti "Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në Rahovec" vlera e kontratës 95,725€ e dt. 07.09.2016 duhej të përfundonte në vitin 2017, ende nuk ka përfunduar; dhe
- Projekti "Rregullimi i qendrës se qytetit me gurë" vlera e kontratës 286,860€ e dt. 16.11.2015 duhej të përfundonte për 155 ditë pune, ende nuk ka përfunduar.

Sipas zyrtarëve komunal vonesat në realizimin e projekteve kanë ndodhur si rezultat i mungesës së fondeve për projektet përkatëse.

Ndikimi

Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që komuna të mos arrijë objektivat e përcaktuara dhe në mungesë të fondeve buxhetore për vitet pasuese, projektet e filluara mund të mos përfundohen edhe një kohë.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që paraprakisht të eliminohen shkaqet e vonesave, të sigurohen fondet e nevojshme si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Rahovecit në 2020 ishin në vlerë prej 1,182,723€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat rrugore, participimet, taksat administrative, taksat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga lejet e ndërtimit etj. Në krahasim me vitin paraprak, niveli i realizimit të të hyrave ishte më i lartë për 6.7%. Përveç këtyre komuna kishte inkasuar edhe të hyra indirekte të cilat mblidhen nga niveli qendror (gjobat në trafik, të gjykatave si dhe nga agjencia e pyjeve) në vlerë prej 212,944€. Kemi testuar shtatë mostra për teste substantivë në vlerë prej 11,746€, si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B5 - Ankesa të shumta nga qytetarët për vlerësimin e pronave**Gjetja**

Sipas neni 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës. Sipas këtij paragrafi ndër përgjegjësitë e Komunës janë si në vijim: regjistron dhe menaxhon të dhënat e tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë, bashkëpunon me Ministrinë e Financave për vlerësimin e pronave të paluajtshme; shqyrton dhe vendos mbi ankesat për tatimin në pronën e paluajtshme.

Përkundër përpjekjeve komuna nuk kishte arritur të ketë një bashkëpunim të duhur sa i përket azhurnimit të informatave në bazën e të dhënave të Tatimit në Pronë dhe vlerësimit të pronave. Rrjedhimisht në komunë kanë mbërritur 103 ankesa në lidhje me vlerësimin jo të duhur të pronave (72 për prona banimi, 25 për prona komerciale dhe 6 për prona industriale). Nga gjithsej 103 ankesa, vetëm 11 janë refuzuar kurse pjesa tjetër e ankesave janë pranuar si të bazuara. Kjo tregon për nivelin e lartë të gabimeve në bazën e të dhënave

Kjo ka ndodhur për shkak të komunikimit të pa mjaftueshëm ndërmjet komunës dhe Ministrisë së Financave dhe për shkak të stafit të limituar në sektorin e Tatimit në pronë, si dhe vështirësive në implementimin e Ligjit të ri nr. 06. L/005.

Ndikimi

Mos azhurnimi i informatave dhe vlerësimi jo i duhur i pronave në bazën e të dhënave të tatimit në pronë mund të vështirësoj inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë dhe njëherësh ndikon në rritjen e llogarive të arkëtueshme si pasojë e pakënaqësisë dhe ankesave të qytetarëve.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të siguroj një koordinim më të mirë ndërmjet Komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të të dhënave në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**2.2.2 Investimet kapitale**

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,388,819€, prej tyre ishin shpenzuar 5,163,679€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, mirëmbajtjen të lumenjve, objektet arsimore, pajisje tjera etj. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 2,128,037€, si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B6 - Realizimi i aktiviteteve jashtë planit të prokurimit dhe mos njoftim i AQP-se**Gjetja**

Bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Prokurimin Publik (me ndryshime dhe plotësime) AK duhet të bëjë planin e prokurimit, në të cilin identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që AK parasheh ti prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë. Ndërsa sipas nenit 9, pika 6, e ligjit të njëjtë precizohet që nëse aktiviteti i prokurimit nuk është përfshirë në planifikimin final të prokurimit, duhet të njoftohet Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) të paktën 5 ditë para autorizimit të inicimit të aktivitetit të prokurimit.

Komuna e Rahovecit në vitin 2020 ka zhvilluar gjithsej 99 aktivitete të prokurimit për pune, furnizime dhe shërbime, prej tyre 23 aktivitete të zhvilluara nuk ishin përfshirë në planin final të prokurimit, megjithëse ishte njoftuar AQP-ja siç kërkohet me LPP-në. Kjo tregon se në planin e prokurimit nuk janë përfshirë të gjitha nevojat për furnizime, punë dhe shërbime. Mirëpo, për katër⁸ raste për aktivitetet e zhvilluara jashtë planit, nuk ishin dërguar në AQP kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërisë e Fondeve para inicimit të aktiviteteve përkatëse të prokurimit.

Mos përfshirja e të gjitha kërkesave/nevojave të njëjësive, në planin e prokurimit ka ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit dhe bashkëpunimit me njësitë tjera të cilat bëjnë kërkesat për prokurim.

Ndikimi

Planifikimi jo i plotë i aktiviteteve prokurimit, dhe realizimi i prokurimeve jashtë planit e vështirësojnë realizimin e planit të prokurimit dhe monitorimin e performancës si dhe krijon vështirësi financiare për komunën.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP komfor kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja C1 - Mos plotësimi i planit për menaxhim të kontratës për punët e kryera****Gjetja**

Sipas nenit 81 të LPP, autoritetet kontraktuese janë të obliguara të përgatisin planin për menaxhim të kontratës. Plani i Menaxhimit të Kontratës (më tutje PMK) është dokument i cili do të përditësohet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Në një rast për projektin "Shtigjet e ecjes te Drini I Bardhe" plani i

menaxhimit të kontratës (PMK) ishte nënshkruar nga menaxheri i kontratës duke mos plotësuar asnjë informatë të kërkuar në këtë dokument. Po ashtu me rastin e testimit pagesave ne asnjë projekt nuk kemi gjetur se menaxheri i projektit ka përditësuar PMK me informata të kërkuara me këtë dokument.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxheri i kontratës nuk e kishte vlerësuar të nevojshme raportimin apo si shkak i neglizhencës së tyre.

Ndikimi Mos plotësimi me informatat dhe mos raportimi për punët e kryera nga menaxheri i kontratës sipas kërkesave të LPP, nuk jep informata të plota për vlefshmërinë e vlerës së paguar dhe obligimeve të mbetura të Kompanisë për punët në proces.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj se menaxheri i kontratës monitoron punën dhe harton raporte lidhur me ecurinë e punës për secilin situacion të pranuar me qëllim të evidentimit të dobësive në proces dhe evitimit të pagesave për punët e papërfunduara. Të siguroj se menaxheret projekteve të kontribuojnë që plani i menaxhimit të kontratës përmban informata të sakta duke prezantuar gjendjen e vërtetë në kohën e duhur.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Zotimi i mjeteve jo sipas rregullave financiare

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013 neni 12 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Nga 70 mostrat e testuar, në 38 pagesa me vlerë 2,048,286€, fillimisht ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja

Shkaku i një dukurie të tillë është planifikimi jo adekuat i buxhetit dhe inicimi i procedurave duke shpërfillur zbatimin e rregullave në fuqi.

Ndikimi Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme ndikojnë në krijimin e obligimeve të cilat e rëndojnë buxhetin e vitit pasues.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 132,950,681€, pasurive jokapitale është 741,381€, si dhe e stoqeve 29,549€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë prej 1,628,119€, dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B7 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Sipas nenit 6, paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare “Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.” Më tutje neni 19, pika 4.7, përcakton se inventarizimi i pasurisë duhet të kryhet para përfundimit të PFV-ve. Po ashtu sipas nenit 20 “Organizata buxhetore duhet të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiar për të vërtetuar nevojshmërinë e pasurisë jo financiare për organizatën, gjendjen fizike dhe mundësinë për ta përdorur në njësitë tjera të organizatës”.

Lidhur me këtë kemi konstatuar se:

- Regjistri i e-pasurisë nuk është i plotë për arsye se blerjet e vitit pasuritë (nën 1,000€) nuk regjistrohen në këtë softuer, edhe pse mbahen në regjistra të brendshëm (Excel).
- Komuna e Rahovecit kishte themeluar komisionin për inventarizimin e pasurive dhe i njëjti kishte përgatitë raportin e përgjithshëm. Ky raport ishte i mangët pasi që përmbante vetëm pasurin e administratës së komunës, por jo edhe për pasuritë jo financiare të shkollave⁹. Po ashtu, Komuna mbante në regjistrin kontabël një kamion me rimorkio me vlerë zero, për me shumë me rastin e ekzaminimit fizik të këtij Kamioni (31701) i cili shërbente për nevojat në pikat grumbulluese peme dhe perime kemi konstatuar se ky automjet ishte në gjendje pasive me vite (i cili ishte çregjistruar me 12/11/2014). Komisioni i inventarizimit një lëshim të tillë nuk e ka evidentuar si parregullsi; si dhe
- Komuna edhe gjatë këtij viti nuk ka aprovuar asnjë rregullore për procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë, përkundër që ishte rekomandim në raportet e viteve të kaluar.

Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës për realizimin e detyrave të përcaktuara me kohë dhe sipas legjislacionit përkatës.

Ndikimi

Mos realizimi i plotë i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë brenda afatit të paraparë ligjore, si dhe mos funksionimi i sistemit e-pasuria rrit rrezikun për informata të mangëta mbi gjendjen e pasurisë. Mungesa e procedurave të brendshme për ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë mund të ndikoj që pasuria e komunës mos të menaxhohet si duhet dhe mos të prezantohet drejtë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të siguroj që kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, ku përmes sistemit e-pasuria evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale. Po ashtu, duhet të siguroj se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë kryhet në të gjitha dikasteret dhe që raportet e komisionit të inventarizimit dhe ai i vlerësimit të finalizuara, të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe ti paraprijnë përgatitjes së PFV për 2021, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet e plot dhe e saktë dhe të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,263,130€. Pjesa më e madhe e tyre kanë të bëjnë me llogarit e arkëtueshme për tatimin në pronë 1,450,150€, taksa në firmë 802,646€, qiraja nga objektet publike 6,030€ etj. Në krahasim me vitin paraprak LL/A janë rritur për 103,441€ apo 4.8%.

Çështja B8 - Nënvlërimi i llogarive të arkëtueshmeve dhe menaxhim jo i duhur i tyre

Gjetja Sipas nenit 16 të Rregullores nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore kërkohet raportim i llogarive të arkëtueshmeve në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Llogaritë e arkëtueshme për tatimin në pronë ishin nënvlërsuar për 15,824€. Komuna në PFV-të e vitit 2020 ka prezantuar këto llogari në vlerë 1,450,150€, ndërsa do të duhej të prezantohej në vlerë prej 1,465,974€. Një pjesë e madhe e borxheve të grumbulluara të tatimit në pronë i përkasin ish ndërmarrjeve shoqërore, të privatizuara gjatë procesit të privatizimit.

Më tutje, Komuna përballet me vlera të larta të llogarive të arkëtueshme të cilat janë duke u rritur nga viti në vit (nga 2.115milion në 2018, prej 2,160milion në 2019, si dhe 2,263milion në 2020).

Përpos aplikimit të vërejtjeve si masë e përdorur nga komuna, mungonin veprime të vazhdueshme si iniciimi i procedurave për arkëtim të detyrueshëm të borxheve nëpërmes organeve tjera kompetent.

Ndikimi Nënvlërimi i LL/A ka ndikuar në shpalosjen jo të drejtë të tyre në PFV. Arkëtimi i borxheve nga debitorët, është bërë barrë dhe e pa menaxhueshme për komunën duke shkaktuar probleme në përmbushjen e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që këto llogari të arkëtohen.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet për Ndërmarrjet Shoqërore nën menaxhimin e tyre dhe të ish-ndërmarrjeve shoqërore. Po ashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e LL/A tjera nga të gjithë pronarët e pronave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm (NJAB) operon me dy anëtar – Drejtori i NJAB-së dhe një zyrtar. Përveç planit strategjik kjo njësi kishte hartuar edhe planin vjetor të punës sipas të cilit ka planifikuar dhjetë(10) auditime, ku për periudhën raportuese për vitin 2020 kishte përfunduar dhe finalizuar 10(Raporte sipas planit, dhe kishte bërë një rishikim për të verifikuar adresimin e rekomandimeve). Komiteti i auditimit ka mbajtur 4(katër) takime të rregullta, i cili me aktivitetet e tij kishte arritur të sigurojë fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.

Çështja C2 - Mangësitë në funksionimin dhe zbatimin e rekomandimeve të NjAB

Gjetja

NJAB kishte dhënë rekomandime se si menaxhmenti të përmirësojë funksionimin e kontrollit të brendshëm. Sipas Planit të veprimit të përgatitur për 2020, nga 39 rekomandime e dhëna, 26 ishin zbatuar, 13 ishin në proces të zbatimit. Në listën kontrolluese të adresimit të rekomandimeve për vitin 2020 sipas auditimeve të përfunduara nga kjo njësi, nuk janë vendosur faktet (dëshmitë dhe dokumentet mbështetëse) që tregojnë se ka veprime konkrete për rekomandimet e zbatuar, nga të gjeturat e auditimit. Po ashtu vlen të theksohet se nga 10 raporte të përfunduara të auditimeve vetëm zyra e prokurimit ka dërguar planin e veprimit të menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve nga raportet e NjAB (kjo është në kundërshtim me procedurat standarde të operimit, të aprovuara nga MF). Një dukuri e tillë ka ndodhur nga mungesa e vëmendjes së duhur, dhe nga neglizhenca e stafit të drejtorive ku janë kryer auditimet.

Ndikimi

Mos dokumentimi i fakteve se ka veprime konkrete se rekomandimi është zbatuar nga drejtorit e audituara me dëshmitë dhe dokumentet mbështetëse të nevojshme do të dëmtoj efektivitetin e punës së NjAB dhe do të zvogëloj mundësinë që ZKA të marrë siguri nga puna e NjAB, përkundër volumit dhe cilësisë së punës së ndërmarrë. Po ashtu dështimi për të adresuar rekomandimet e auditimit të brendshëm mund të rezultojë me vazhdimin e dobësive të identifikuara, jo efikasitet në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi C2

Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani vjetor i auditimit të fokusohet më shumë në proceset e vitit aktual në departamentet ku vlerësohet që rreziku është më i lartë, të kërkojë që cilësia e auditimit të përmirësohet dhe nga departamentet të kërkohet që rekomandimet e auditimit të trajtohen në pajtim me procedurat standarde të operimit të aprovuara nga Ministri i Financave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

“Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹¹	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	14,735,820.41	15,454,054.71	15,129,427.04	14,688,601.82	13,064,948.77
Grante Qeveritare – Buxheti	13,578,979.41	13,810,445.03	13,743,871.40	13,192,921.81	11,995,390.75
Financimi përmes huamarrjes	0.00	110,660.00	100,019.60	92,191.42	37,333.40
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	372,526.46	309,042.56	376,713.94	153,711.95
Të hyrat vetanake	1,156,841.00	1,156,841.00	974,370.16	961,842.35	778,166.97
Donacionet vendore	0.00	3,487.00	2,123.32	652.30	4,852.70
Donacionet e jashtme	0.00	95.22	0.00	64,280.00	95,493.00

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 718,235€. Kjo rritje është rezultat i rishikimit të buxhetit, të hyrave të bartura nga viti paraprak, rritjes së garantit qeveritar, donacioneve vendore dhe financimit nga huamarrja.

Në vitin 2020 Komuna ka shpenzuar 98% të buxhetit final ose 15,129,427€, me realizim po thuajse të njëjtë me vitin e kaluar (2019 – 97%). Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	14,735,820.41	15,454,054.71	15,129,427.04	14,688,601.82	13,064,948.77
Pagat dhe mëditjet	7,556,821.00	7,716,938.32	7,716,523.13	7,330,406.30	7,219,001.22
Mallrat dhe shërbimet	1,594,330.00	1,746,797.96	1,664,862.25	1,352,072.18	975,105.46
Komunalitë	280,500.00	280,500.00	263,829.83	246,469.32	248,822.91
Subvencionet dhe transferet	311,000.00	321,000.00	320,532.48	1,216,728.26	179,062.00
Investimet Kapitale	3,905,770.41	5,388,818.43	5,163,679.35	4,542,925.76	4,442,957.18
Rezervat	1,087,399.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


- Buxheti final për paga dhe mëditje është rritur për 160,117€ me rishikim të buxhetit. Kjo ka ndodhur për arsye të angazhimit të stafit për pandeminë Covid -19;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 152,468€ si rezultat i rishikimit të buxhetit;
- Buxheti final për shpenzimet komunale në krahasim me buxhetin fillestar nuk ka pasur ndryshime , ndërsa te kategoria e subvencioneve është rritur për 10,000€;
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,483,049€. Kjo rritje është rezultat i rishikimit të buxhetit si kërkesë për realizimin e projekteve nga vitet paraprake dhe bartjes së mjeteve nga rezervat në vlerë 993,844€ me vendim të Kuvendit Komunal.

Komuna për menaxhimin e pandemisë Covid – 19, kishte shpenzuar 410,079€, prej të cilave 267,592€ janë paguar për paga dhe mëditje, 132,487€ për mallra dhe shërbime dhe 10,000 për subvencione

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Në krahasim me vitin paraprak, të hyrat e realizuar në vitin 2020 ishin më të larta për 112,555€. Përveç këtyre komuna kishte inkasuar edhe të hyra indirekte të cilat mbledhen nga niveli qendror (gjobat në trafik, të gjykatave si dhe nga agjencia e pyjeve) në vlerë prej 212,944€

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	1,156,791.00	1,156,791.00	1,182,723.25	1,103,402.89	994,863.65
Të hyrat tatimore	541,173.00	541,173.00	456,977.38	459,286.37	419,434.14
Të hyrat jo tatimore	615,618.00	615,618.00	725,745.87	644,116.52	575,429.51

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Rahovecit ka rezultuar me 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Menaxhmenti i Komunës së Rahovecit ka ndërmarrë veprime për t'i adresuar çështjet e ngritura, ku deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, tre rekomandime ishin zbatuar, përderisa tetë nuk ishte adresuar ende, dy të tjerat ishin në proces si dhe një rekomandim i mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni më poshtë Tabelën e rekomandimeve:

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr.	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë të gjitha veprimet në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet me përpikëri sipas kodeve ekonomike adekuate, po ashtu të gjitha obligimet të paguhen me kohë në mënyrë që të shmanget mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore.	Kjo çështje do të trajtohet në Raportin vjetor të auditimit RVA.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Të hyrat	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se janë intensifikuar aktivitetet e përbashkëta të Komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të të dhënave në bazën e të dhënave.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të kërkoj nga personat përgjegjës, që për zyrtarët të cilët paguhen nga buxheti i komunës të sigurohen së paku dosjet me informata bazike përfshirë kontratat e punës, si dhe raportet mujore për vijueshmërinë e tyre në punë, për tu siguruar se janë paguar vetëm punëtorët legjitim dhe që kanë ofruar shërbimet.	Janë ndërmarrë veprime nga menaxhmenti	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se ekzekutimi i pagesave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren e MF. Përparësi duhet tu ipet obligimeve të bartura nga viti paraprak dhe atyre që kanë afat më të gjatë të pritjes.	Nuk janë ndërmarrë veprime te nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që pagesat të kryhen vetëm pas sigurimit se janë pranuar shërbimet e kontraktuara dhe konfirmimit se ato janë në pajtim me kushtet e kontraktuara. Secila pagesë e shërbimeve të tilla duhet të mbështetet me dokumentacion komplet, duke përfshirë faturat dhe dëshmitë e pjesëmarrjes.		I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të iniciojë një rishikim të zbatimit të kësaj kontrate për të siguruar se ajo po zbatohet sipas specifikimeve të kontraktuara. Për secilin muaj duhet të hartohen raporte detale për secilin shërbim të ofruar dhe pagesat duhet të bëhen vetëm pasi të jetë marrë siguria se shërbimet janë pranuar. Për rastet e lartpërmendura ku nuk ka dëshmi të besueshme se janë ofruar shërbimet dhe është kryer pagesa, duhet të konsiderohet mundësia e kthimit të mjeteve në buxhetin e komunës. Personat përgjegjës për menaxhimi e kësaj kontrate duhet të mbahen përgjegjës për punën e tyre.	Nuk janë ndërmarrë veprime te nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që kontratat e planifikuara sipas planit vjetor të prokurimit si furnizime, të trajtohen të tilla edhe gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit dhe pagesave, për të siguruar klasifikim/pasqyrim të saktë të shpenzimeve. Po ashtu, duhet të respektohen të gjitha dispozitat e LPP-së në lidhje me procedurat e prokurimit.	Nuk është zbatuar	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të siguroj që për çdo kontratë me vlerë të mesme dhe të madhe të emërohen menaxherët e kontratave, në pajtim me kërkesat e LPP-së, dhe menaxherëve të kontratave duhet tu bëhen të qarta kërkesat ligjore në lidhje me menaxhimin e kontratave. Rrjedhimisht ata duhet të përgatisin, monitorojnë dhe raportojnë në lidhje me planin për menaxhim të kontratës, komfor kërkesave.	Janë emëruar menaxheret e kontratave, mirëpo edhe më tutje nuk janë monitoruar në mënyrë adekuate.	Pjesërisht i zbatuar
9.	Investimet	Kryetari duhet të siguroj se do të aplikoj	Nuk janë	Nuk ka filluar

	kapitale	ligjin e prokurimit - të inicioj një aktivitet prokurimi vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave dhe të nënshkruaj një kontratë për projekte kapitale vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.	ndërmarrë veprimet te nevojshme.	zbatimi
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP konform kërkesave ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprime te nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
11.	Pasuritë	Kryetari i Komunës duhet të kërkoj nga Ministri i Kulturës Rinisë dhe Sportit të gjitha informacionet financiare në lidhje me objektin-palestrën Sportive dhe në bazë të këtyre informatave kjo pasuri duhet të përfshihet në regjistrat e e pasurive të Komunës.	Janë ndërmarrë veprime nga menaxhmenti	I zbatuar
12.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare të bëj regjistrimet dhe vlerësimin e të gjitha pasurive në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.	Nuk janë ndërmarrë veprime konkrete	Nuk ka filluar zbatimi
13.	Llogaritë arkëtueshme e	Kryetari duhet të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhjen e përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet për Ndërmarrjet Shoqërore nën menaxhimin e tyre dhe të ish-ndërmarrjeve shoqërore. Po ashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e LL/A tjera nga të gjithë pronarët e pronave.	Nuk janë ndërmarrë veprime te nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
14.	Auditimi Brendshëm i	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani vjetor i auditimit të fokusohet më shumë në proceset e vitit aktual në departamentet ku vlerësohet që rreziku është më i lartë, të kërkojë që cilësia e auditimit të përmirësohet dhe nga departamentet të kërkohej që rekomandimet e auditimit të trajtohen në pajtim me procedurat standarde të operimit të aprovuara nga Ministri i Financave.	Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së nuk ishin përgatitur nga drejtorit përkatëse.	Pjesërisht i zbatuar

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për	Kryetari duhet të forcojë kontrollin në procesin e menaxhimit të pagesave për të

	konkluzion	siguruar që komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme dhe që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të iniciojë një rishikim të zbatimit të kësaj kontrate për të siguar se ajo po zbatohet sipas specifikimeve të kontraktuara. Për secilin muaj duhet të hartohen raporte detale për secilin shërbim të ofruar dhe pagesat duhet të bëhen vetëm pasi të jetë marrë siguria se shërbimet janë pranuar.
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se do të aplikoj ligjin e prokurimit - të inicioj një aktivitet prokurimi vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave dhe të nënshkruaj një kontratë për projekte kapitale vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj bashkëpunim më të mirë në mes të tatim-paguesve, departamentit të Tatimit në Pronë-Komunës dhe departamentit të Tatimit në Pronë-Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventual.
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që paraprakisht të eliminohen shkaqet e vonesave, të sigurohen fondet e nevojshme si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik.
6.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurohet se drejtoritë që realizojnë të hyra bëjnë barazimin me zyrtarin e të hyrave në baza të rregullta mujore bazuar në dokumente burimore dhe raportet e bankës duke eliminuar me kohë edhe dobësitë apo gabimet e mundshme.
7.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj një koordinim më të mirë ndërmjet Komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të të dhënave në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin.
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP komfor kërkesave ligjore.
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se menaxheri i kontratës monitoron punën dhe harton raporte lidhur me ecurinë e punës për secilin situacion të pranuar me qëllim të evidentimit të dobësive në proces dhe evitimit të pagesave për punët e papërfunduara. Te siguroj se menaxheret projekteve mund të kontribuojnë që plani I menaxhimit të kontratës përmban informata të sakta duke prezantuar gjendjen e vërtetë në kohën e duhur.
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.
11.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj që kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, ku përmes sistemit e-pasuria evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale. Po ashtu, duhet të siguroj se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë kryhet në të gjitha dikasteret dhe që raportet e komisionit të inventarizimit dhe ai i vlerësimit të finalizuar, të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe të paraprijnë përgatitjes së PFV për 2021, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet e plotë dhe e saktë dhe të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë.
12.	Llogaritë arkëtueshme	Kryetari duhet të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet për Ndërmarrjet Shoqërore nën menaxhimin e tyre dhe të ish-ndërmarrjeve shoqërore. Po ashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e LL/A tjera nga të gjithë pronarët e pronave.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm




Arian Haxha, Udhëheqës i Auditimit



Kapllan Muhaxheri, Udhëheqës i ekipit



Mehmet Kurti, Anëtar i ekipit



Hysen Boqolli, Anëtar i ekipit



Florim Maliqi, Anëtar i ekipit



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹² duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.¹³ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. Opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen (t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi (et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit (eve) material (e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë (ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit (eve) material (e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- 1 Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- 2 Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- 3 Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- 4 Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- 5 [*} Kemi vonesa prej 31 ditëve-1981ditë
- 6 [*]]Për muajin Janar, Shkurt, Maj, Qershor, Korrik dhe Nëntor.
- 7 Kanali i kullimeve te Tokave bujqesore ne shume 49,699 (Kontrata me 01.10.2013)
- 8 [*]Ndertimi I ngrohjes qendrore ne shkollat Pataqan dhe Senoc ne shume prej 42,405, Mirembajtja e ndriqimit publik ne shume prej 196,262€, Shtigjet e ecjes te Drini I bardhe ne shume prej 59,859€ si dhe Hartimi I strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal ne shume prej 17,017€.
- 9 [*]Shkolla Fillore “Bekim Sylka” në Rahovec ,Shkolla Fillore “Isa Boletini” në Rahovec, Shkolla Fillore “Isa Boletini” f.sh Celinë, si dhe Shkolla Fillore “Sapniq” në F.sh Sopniq.
- 10
- 11 Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- 12 Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- 13 Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.